

Pozita	Zyrtar për standarde profesionale
Nr. i referencës	IKAF-07
Lloji i Kontratës	Kontratë e rregullt
Raporton	Drejtorit Ekzekutiv
Departamenti/Komisioni	Departamenti për zhvillim Profesional
Forma e angazhimit	Me orar të plotë
Nr. i pozitave	1
Vendi:	Prishtinë

**Instituti KAF** është i përkushtuar në ndërtimin e profesionit të kontabilistëve dhe auditorëve në bazë të parimeve të larta Profesionale Etike, Standardeve Ndërkombëtare, sipas Rregulloreve të Ligjit në fuqi dhe sipas plan-programit të harmonizuar me ACCA dhe IIA Global.

#### Detyrat e Zyrtarit për Standarde Profesionale:

- a) Përcjell zhvillimet në standardet globale/ndërkombëtare dhe Evropiane dhe në udhëzimet që kanë të bëjnë me punën e anëtarëve të Institutit KAF në të gjithë sektorët e ekonomisë;
- b) Asiston në monitorimin e përkthimit dhe publikimit të drafteve të publikuara dhe propozimet tjera të standard-vënësve global, Evropian dhe Kosovare të cilët kanë ndikim në punën e anëtarëve të Institutit KAF dhe në ekonominë e Kosovës;
- c) Monitoron publikimet e standard-vënësve global, regional dhe lokal dhe i jep rekomandime Komisioneve të Institutit KAF për implementimin e çështjeve si dhe përgatit propozimet e përgjigjeve të Institutit KAF ndaj kërkesave formale për komente;
- d) Bashkëpunon dhe koordinon punën e komisioneve të Institutit KAF dhe përkrah punën e tyre në zhvillimin e metodave, teksteve dhe udhëzimeve për t'i ndihmuar anëtarët që të jenë në përputhje me standardet profesionale;
- e) Mban kontaktet e vazhdueshme me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe me palët e ndërlidhura për zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit;
- f) Asiston Departamentin për zhvillim Profesional Profesionale në promovimin e metodave dhe mjeteve efektive të edukimit profesional, duke përfshirë por pa u limituar në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë;
- g) Përkrah anëtarët e Institutit KAF dhe institucionet e Kosovës në implementimin e standardeve profesionale;

**Kushtet e nevojshme:**

Për titullin **Zyrtar për standarde profesionale**, kandidati duhet të dëshmojë dokumentacionin si më poshtë:

1. Dëshmon kualifikimin akademik dhe profesional
2. Dëshmon nivel të lartë dhe kompetencë profesionale që dëshmohet me:
  - a) Një numër të rëndësishëm të punimeve apo publikimeve
  - b) Pjesëmarrje aktive në seminare, konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - c) Të ketë së paku tre (3) vite eksperiencë në përdorimin e vazhdueshëm të standardeve profesionale;
  - d) Gjuha angleze obligative;
  - e) Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
  - f) Njohuri të theksuar të SNK/SNRF/SNA.